



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/24-0032567/25 dt. 05-06-2025
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 11 dhe 12 të Rregullores komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, dhe Kërkesën Elektronike nga Zyra e Kryetarit të dt. 04.06.2025, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Ankesave për Ndarje të Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve me Thirrje Publike)

1. **Formohet** Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Ankesave për Ndarje të Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve me Thirrje Publike, në këtë përbërje:
 - 1.1 Fatime Hyseni – kryesuese (DSHPI);
 - 1.2 Agon Bytyqi – anëtar (DKA);
 - 1.3 Bedri Muja - anëtar (DI).
2. Komisioni është përgjegjës që të shqyrtojë të gjitha ankesat e parashtruara nga palët e pakënaqura me Vendimin e Komisionit Vlerësues, qoftë për mospërmbylljen e kriterëve procedurale apo kriterëve materiale, të cilat kanë aplikuar në bazë të Thirrjes Publike nga Njësia përkatëse.
3. Gjatë shqyrtimit të ankesave komisioni i lartcekur është i obliguar që të hartojë Procesverbal për mbarëvajtjen e procesit, dhe të marrë Vendim për secilën ankesë për miratimin apo refuzimin e saj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e përfundimit të periudhës për paraqitje të ankesës, dhe këto Vendime i dërgohen Njesisë përkatëse dhe të publikohen në ueb - faqen e Komunës.
4. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Rregulloren Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5. Vendimet e Komisionit për shqyrtimin e Ankesave për Ndarje të Subvencioneve Transfereve dhe Granteve me Thirrje Publike janë përfundimtare në Procedurën Administrative.
6. Komisioni i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi ka mandat 1 (Një) vjeçar.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Bedri HAMZA

Shtojcë:

1x1 Kërkesa elektronike nga Zyra e Kryetarit, dt. 04.06.2025

Ti dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Drejtorëve të Drejtorive Komunale
- 1x1 Arkivit

